



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

5646

Prishtinë, Dt. 12.10.2023

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Departamenti i Kimisë (Programi: Kimi Organike)
Projektpropozimi	Hulumtimi i faktorit mbrojtës SPF tek ekstraktet e bimës Mentha Spicata Investigation of SPF protection factor in plant extracts Mentha Spicata
Kandidati	Zemile Bushi
Mentori	Prof. Asoc. Dr. Hamit Ismaili
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28.04.2023 Vendimi nr.:1879

Vlerësimi i dorëshkrimit

Lënda: Raport recenzues për vlerësim të dorëshkrimit të temës së masterit

Këshilli i FSHMN-së i Universitetit të Prishtinës, në seancën e 55^{te} të rregullt të mbajtur më 27.04.2023 (vendimi nr. 1879) ka aprovuar projekt-propozimin për temë diplome të masterit me titull: "**Hulumtimi i faktorit mbrojtës SPF tek ekstraktet e bimës Metha Spicata**", të kandidatës Zemile Bushi, ka formuar komisionin vlerësues në përbërje:

Prof. Asoc. Dr. Hamit Ismaili, kryetar

Prof. Dr. Ramiz Hoti, anëtar

Prof. Dr. Arben Haziri, anëtar

Ndërsa si mentor është caktuar Prof. Asoc. Dr. Hamit Ismaili

Pas kërkesës së kandidatës për vlerësimin e dorëshkrimit, Komisioni vlerësues ka analizuar dorëshkrimin e kandidatës. Pas shqyrtimit të dorëshkrimit, kemi nderin që Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore t'i paraqesim këtë:

RAPORT

Të dhënat e përgjithshme

Punimi i diplomës së masterit me titull: "Hulumtimi i faktorit mbrojtës SPF tekë ekstraktet e bimës *Menta Spicata*", i kandidatës Zemile Bushi, Master i Kimisë, është shkruar në 53 faqe. Dorëshkrimi përfshinë hyrjen, abstraktin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, pjesën teorike, metodat dhe materialet, rezultatet dhe diskutimin, përfundimin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, literatura e cila përmban gjithsejt 22 të dhëna bibliografike të kohëve të fundit dhe biografinë.

Ky dorëshkrim përmban 34 figura dhe 34 tabela.

Analiza e dorëshkrimit

Fillimisht kandidatja ka paraqitur një hyrje të shkurtër dhe qëllimin e këtij punimi, ku janë paraqitur arsyetimet dhe për përcaktimin në këtë fushë hulumtuese.

Në kapitullin e dytë (pjesa teorike) autorja është përqendruar në prezantimin e publikimeve të reja nga lëmia e ngushtë e hulumtimeve të faktorit mbrojtës SPF tekë ekstraktet e bimëve dhe efektet e tyre në lëkurë.

Në kapitullin e tretë kandidatja ka paraqitur rrezikun e ekspozimit të trupit të njeriut ndaj ekspozimit të rrezeve UVA (320-400nm) dhe UVB (290-320nm) dhe efektet e tyre si në plakjen më shpejt po ashtu edhe në paraqitjen e llojeve të ndryshme të smundjeve të lëkurës.

Në kapitullin e katërtë, janë paraqitur metodat dhe materialet dhe në mënyrë të detajizuar janë përshkruar procedurat eksperimentale të cilat janë aplikuar gjatë këtij hulumtimi. Në këtë kapitull janë përshkruar metodat e ekstraktimit, mjetet e përdorura dhe llojet e tretësave që janë përdorur për ekstraktimin e përbërjeve organike nga ekstraktet e bimës të cilat janë marr nga rajonet me klimë dhe relief të ndryshëm të Kosovës. Në këtë kapitull kandidatja ka paraqitur mënyrën e trajtimit të ekstrakteve të bimës, gjithashtu ka paraqitur edhe llojllojshmërinë e trajtimit të këtyre ekstrakteve me tretësa të ndryshëm organik me qëllim të ekstraktimit sa më të mirë të lëndëve organike të cilat kanë efekt mbrojtës kundër rrezeve UV të dëmshme diellit të njohura si SPF (sun protection factor).

Në kapitullin e pestë (rezultatet) autorja ka paraqitur rezultatet e fituara në mënyrë eksperimentale nga bima *Menta Spicata* e rajoneve të caktuara të Kosovës, të cilat rezultate i ka paraqitur dhe argumentuar nga të dhënat spektrofotometrike. Të dhënat e fituara me metodë spektrale autorja i ka llogaritur me formulën e quajtur *Mansur equation*, me ç'rast ka fituar edhe vlerat e SPF të paraqitura tabelë.

Në kapitullin e gjashtë dhe shtatë kandidatja ka paraqitur konkluzionet në gjuhë shqipe dhe angleze lidhur me rezultatet eksperimentale të fituara gjatë këtij hulumtimi.

Kurse në fundë të këtij dorëshkrimi kandidatja ka paraqitur të dhënat bibliografike-literatura ku janë paraqitur 23 të dhëna të literaturës dhe autobiografija e kandidates.

Vlerësim dhe propozim

Punimi i diplomës së masterit me titull: “ **Hulumtimi i faktorit mbrojtës SPF në ekstraktin e bimës Mentha Spicata**”, i kandidatës **Zemile Bushi** paraqet një kontribut për shkencën e kimisë organike hulumtuese, poashtu krijon një bazë solide që këto rezultate të fituara të gjejnë aplikim në shkencat mjekësore farmaceutike. Rezultatet e këtij punimi janë origjinale dhe punimi është shkruar në mbështetje të normave për organizimin e punimit shkencorë dhe si i tillë i përmbushë të gjitha kriteret shkencore.




Në bazë të fakteve të lartëshënuara mund të konkludojmë që kandidatja **Zemile Bushi**, gjatë këtij hulumtimi shkencorë ka bërë një punë të qmueshme dhe serioze. Ky punim paraqet një kontribut shkencor në aspektin fundamental në lëminë e kimisë organike, në hulumtimin e faktorëve mbrojtës SPF në ekstraktin e bimëve e ndryshme të rritura në vendin tonë, dhe mundësia e aplikimit të tyre rezultateve në praktikë.

Të gjitha sygjerimet dhe vërejtjet e dhëna, me seriozitet naj pranuar nga kandidatja.

Në bazë të kësaj i propozojmë Këshillit të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës që punimin “ **Hulumtimi i faktorit mbrojtës SPF tekë ekstraktet e bimës Mentha Spicata**”, të kandidatës **Zemile Bushi**, t’a pranoj si bazë për arritjen e titullit shkencorë master i shkencave të kimisë dhe ta përcjell në procedurë të mëtutjeshme.

Prishtinë, _____

Komisioni:

1. Prof. Dr. Ramiz Hoti  - kryetar/
2. Prof. Asoc. Hamit Ismaili  mentor/
3. Prof. Dr. Arben Haziri  anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.